



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 645 Akti

Nr. 699 Vendimi
Tiranë, më 18.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në dijeni edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 18.9.2023, mori në shqyrtim mbi bazën e dokumenteve të administruara çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Murat Lleshi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, komisioneren Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të administruara, deklarimet e subjektit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi në raport me ligjin e zbatueshëm, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Murat Lleshi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë Gjyqësor.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Murat Lleshi, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Brunilda Bektashi dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bektashi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Murat Lleshi, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 14.1.2021, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike në adresën e *email-it* ***@gmail.com përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Në datën 27.1.2023 dhe 17.2.2023, Komisioni në adresën e *email-it* ***@gjykata.gov.al i njoftoi/rikërkoi subjektit: (a) fillimin e procedurës së rivlerësimit; (b) deklarin e konfliktit të interesit; (c) plotësimin e pyetësorit standard dhe dërgimin e dokumentacionit në mbështetje të tij. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, në datën 13.4.2023, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 4.7.2023, Komisioni me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Murat Lleshi, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, vlerësimi i aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda datës 17.7.2023 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti nuk e ushtroi të drejtën për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni.

7. Në datën 5.5.2023, subjekti i rivlerësimit: (i) u njoftua lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) u njoftua me kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) u njoftua të sjellë prova për të provuar të kundërtën brenda 12 ditëve. Në datën 17.7.2023, subjekti dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Në datën 17.7.2023, subjekti njoftoi Komisionin se ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën (datë 11.7.2023 me *email* dhe datë 17.7.2023 zyrtarisht) për dalje në pension të parakohshëm. Në datën 18.7.2023, në referim të njoftimit të tij, Komisioni i kërkoi subjektit të qartësonte pozicionin e tij lidhur me vijimësinë e procedurës së rivlerësimit të tij, duke i

bërë me dije pasojat ligjore që passillte paraqitja e kërkesës së tij gjatë procesit të rivlerësimit edhe sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

9. Në të njëjtën datë, mbi kërkimin e Komisionit subjekti ka parashtruar se në datën 17.7.2023 ka paraqitur qëndrimin e tij mbi rezultatet e hetimit, me qëllim të qartësimit të situatës dhe për të qenë bashkëpunues në lidhje me këtë proces. Sa i takon njoftimit për paraqitjen e kërkesës së tij, në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për daljen në pension të parakohshëm subjekti deklaroi se: (i) i qëndron kësaj kërkesë për arsye të plotësimit të kriterëve ligjore, moshës dhe vjetërsisë si gjyqtar; (ii) në lidhje me pasojat ligjore, aplikimin e pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës, që passjell paraqitja e kësaj kërkesë gjatë procesit të rivlerësimit sipas jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, subjekti deklaroi se u njoh me jurisprudencën e Kolegjit dhe pasojat ligjore; (iii) lidhur me pozicionin e tij mbi vijimësinë e procedurës së rivlerësimit, subjekti parashtroi se pas shqyrtimit të kërkesës nga KLGJ-ja për dalje në pension të parakohshëm dhe pranimit të saj, nuk kërkon të rikthehet në sistem si gjyqtar apo prokuror etj. në të ardhmen.

10. Në vijim, Komisioni administroi shkresën¹ e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me anë të së cilës përcillej vendimi “Për miratimin e pensionit të parakohshëm dhe deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit gjyqtar Murat Lleshi”.

11. Komisioni vëren se Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 86, shkronja “ë” e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenet 27, pikat 1, 1/2 dhe 64, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 24.7.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së subjektit për dalje në pension të parakohshëm, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për z. Murat Lleshi, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 15.9.2023. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistratit, gjyqtarit Murat Lleshi etj.

12. Me qëllim konkludimin brenda procedurave të një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në datën 26.7.2023, nëpërmjet postës elektronike, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklaronte nëse kishte ushtruar ankimi ndaj vendimit të lartpërmendur të KLGJ-së, si dhe të shprehte vullnetin e tij lidhur me paraqitjen në seancë publike.

13. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet postës elektronike të datës 28.7.2023, bëri me dije se nuk do të ushtronte ankimi ndaj vendimit nr. ***, datë 24.7.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk do të paraqitej në seancë dëgjimore, duke konfirmuar dhe rishprehur kështu vullnetin e tij të pavesuar në raport me mbarimin e statusit të magjistratit dhe mosushtrimin të së drejtës së tij për t’u dëgjuar sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

14. Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 4.9.2023, i kërkoi Gjykatës Administrative të Apelit nëse subjekti Murat Lleshi kishte ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të KLGJ-së. Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. *** prot., datë 7.9.2023, ka kthyer përgjigje, duke informuar se z. Murat Lleshi deri në datë 6.9.2023, nuk ka paraqitur ndonjë ankimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit ndaj vendimit nr. ***, datë 24.7.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹ Administruar me *email-in* e datës 26.7.2023 dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.7.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2023.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

15. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

16. Trupi gjykues konstaton se z. Murat Lleshi, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio* referuar përkufizimit të termit “magjistrat” në ligjin nr. 96/2016, në shkronjën “gj” të nenit 2, të këtij ligji.

17. Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 164 të ligjit nr. 96/2016 parashikohet se: *“Gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, por ky status do të mbahet vetëm nëse kalohet me sukses procesi i rivlerësimit dhe konfirmohen në detyrë”*.

18. Rastet e mbarimit të statusit të magjistratit janë përcaktuar në pikën 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016: (a) jep dorëheqjen; (b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; (c) mbush moshën 67 vjeç; (ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; (d) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

19. Trupi gjykues mbi faktet e dala, ndonëse subjekti ka ezauruar të drejtën e tij ligjore për të dalë në pension të parakohshëm, konstaton se gjatë procesit ai ka shprehur vullnetin për të mos u kthyer më në sistem si gjyqtar apo prokuror etj. në të ardhmen. Po ashtu, rezulton se subjekti konfirmoi faktin se ai është njohur dhe ka pranuar pasojat ligjore për efekt të ligjit nr. 84/2016, që passjell paraqitja e një kërkesë të tillë gjatë procesit të rivlerësimit, duke deklaruar mosushtrimin e të drejtës për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

20. Shprehja e vullnetit të subjektit për të mos u kthyer më në sistem, bërja prezent para Komisionit e këtij fakti pas formalizimit të kërkesës së tij për dalje në pension të parakohshëm, çmohen nga trupi gjykues si fakte të çështjes për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, për shkak të vullnetit të subjektit për t’u dorëhequr nga detyra përpara kohe, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet për të kualifikuar këtë situatë faktike sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

21. Për sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në njohjen, pranimin dhe moskontestimin nga ana e subjektit të rivlerësimit, të pasojave ligjore që sjell paraqitja e një kërkesë të tillë gjatë procesit të rivlerësimit, e shoqëruar edhe me dorëheqjen e subjektit për shkak të vullnetit të tij për të mos u kthyer më në sistem, çmon që përveç ndërprerjes së procesit të rivlerësimit, të aplikojë/vendosë edhe ndalimin e emërimit të subjektit të rivlerësimit gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Murat Lleshi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Ndalimin e emërimit të z. Murat Lleshi si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 18.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Etleđa ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka